



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Përgjithshëm



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201401559/2

Tiranë ___/___/2014

Lënda: *Marrjen e masave për dhënien e menjëhershme të shtesës mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim pa aftësie, shtetasit S.C për periudhën 01.09.2012-01.09.2014*

Drejtuar : **Znj. Jeta Seitaj**
Kryetare e Njesisë Bashkiake Nr.5

TIRANË

E nderuar zonja Seitaj,

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit ka paraqitur ankesë shtetasi S.C, lidhur me mospërfitimin e së drejtës së pagesës së aftësisë së kufizuar si shtesë në pensionin e invaliditetit për periudhën 01.09.2012-01.09.2014.

Sipas shpjegimeve të parashtruara në ankesë, në muajin Shtator 2012, pas vlerësimit të gjëndjes shëndetësore, KMCAP-i Tiranë e ka deklaruar me grup të plotë të invaliditetit. Ka përfituar pension invaliditeti, por nuk ka përfituar shtesën prej 3300 lekësh në muaj, pagesa e aftësisë së kufizuar, që nga data 01.09.2012. Ky përfitim ankuesit i njihet vetëm nga data 01.09.2014. Kjo për arsye se nga ana e KMCAP-it Tiranë është pajisur me vërtetimin për përfitimin e kësaj shtese edhe për periudhat e kaluar, pas daljes së tij në komisionimin e fundit, datë 25.08.2014.

Ankuesi pretendon se pavarësisht se është pajisur me vërtetimet përkatëse për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar edhe për periudhën 01.09.2012-01.09.2014, atij nuk i është dhënë kjo e drejtë. Madje i është thënë se vërtetimi duhet të mbajë datat në vitet kur janë bërë dy komisionimet e para. Në këto kushte atij i është dhënë e drejta për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar vetëm nga muaji Shtator 2014.

Shtetasi S.C, e konsideron këtë çështje si shkelje të të drejtave të tij të ligjshme, pasi bazuar në legjislacionin në fuqi, i takon të përfitojë shtesën në pensionin e invaliditetit.

Duke cilësuar mosveprimin tuaj për dhënien e kësaj të drejtë në kundërshtim të plotë me përcaktimet e bëra në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë

14.12.1994 "*Statusin e Invalidit*", ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për shqyrtimin e këtij rasti dhe mundësimimin e përfitimin e pagesës së paaftësisë.

Institucioni i Avokatit të Popullit, si një institucion kushtetues në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike, si dhe të të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka vendosur pranimin e ankesës dhe shqyrtimin e saj.

Nga dokumentacioni bashkangjitur ankesës, rezulton se:

Shtetasi S.C me vendimin nr.1177 datë 27.07.2012 është deklaruar nga KMCAP-i Tiranë me grup të dytë të invaliditetit për periudhën 01.09.2012-01.09.2013: me vendimin nr.1464 datë 30.09.2013 është deklaruar me grup të dytë të invaliditetit për periudhën 01.09.2013-01.09.2014; me vendimin nr.1585 datë 25.08.2014 është deklaruar me grup të dytë të invaliditetit për periudhën 01.09.2014-01.09.2015.

Gjithashtu ky shtetas, nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, është pajisur me dy vërtetime "*Për invaliditet të plotë nga sëmundje të përgjithshme*". Njëra me nr.2129 datë 18.07.2014. ku pensioni i invaliditetit (të plotë) e përfiton për periudhën 01.09.2012-01.09.2013 dhe tjetra me nr. 2128 datë 18.07.2014, me atën e të cilit vërtetohet se pensionin e invaliditetit (të plotë), e përfiton për periudhën 01.09.2013-01.09.2014.

Nga korrespondenca që ankuesi ka patur me Njësinë tuaj Bashkiake, i është kthyer përgjigje më datë 29.07.2014. Në këtë shkresë thuhet se:

"Në mbështetje të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në zbatim të pikës 6 të VKM nr.869 datë 18.06.2008 "Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidit", i ndryshuar, udhëzohet:

1. Për personat që komisionohen për herë të parë dhe përfitojnë Statusin e invalidit të punës, pagesa e paaftësisë fillon në muajin pasardhës pas daljes në KMCAP të përcaktuar sipas Vërtetimit tip.

Duke u bazuar në sa më sipër informojmë z.S.C, se pagesa e invaliditetit i fillon në muajin Gusht 2014, sepse vërtetimet e gjata mbajnë datën 18.07.2014".

Në analizë të akteve ligjore e nënligjore për përfitimet e të drejtave të personave me aftësi të kufizuar, konkretisht të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 869 datë 18,06,2008 "Për zbatimin e Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 "Për Statusin e Invalidit", pika 1/a, personave përfitues, sipas përcaktimeve të nenit 1 të Ligjit nr. 7889 datë 14.12.1004 "Për Statusin e Invalidit", të ndryshuar, u jepet një shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim paaftësi, në masën:

-3300 lekë në muaj, nëse janë invalidë të plotë, nga sëmundje të përgjithshme...'

Nga sa rezulton ankuesi i ka marrë vërtetimet përkatëse për përfitimin e shtesës mbi pensionin e invaliditetit që nga data e lindjes të së drejtës, 01.09.2012.

Pra, sa më lart, arrihet në konkluzionin se kemi të bëjmë me shkelje të së drejtës për të përfituar pagesën e aftësisë së kufizuar, si shtesë mujore mbi pensionin e invaliditetit.

Për sa më sipër, me qëllim që ankuesi të përfitojë të drejtat e tij ligjore, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; në bazë të nenit 21/b të Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se : *“Paraqet rekomandime për venien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”*,

REKOMANDOJMË

Marrjen e masave për dhënien e menjëhershme të shtesës mujore mbi pensionin e invaliditetit, si përfitim pa aftësie, shtetasit S.C për periudhën 01.09.2012-01.09.2014.

Në përputhje me nenin 22, të Ligjit Nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, ku thuhet se;

“Organet të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar një rekomandim, kërkesë apo propozim për shkarkim, duhet t’a shqyrtojnë rekomandimin, kërkesën apo propozimin për shkarkim dhe të kthejnë përgjigje brenda 30 ditësh nga data e dërgimit të rekomandimit, kërkesës apo propozimit për shkarkim. Përgjigja duhet të përmbajë shpjegime të arsyetuara për çështjen në fjalë, si dhe çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash ka ndërmarrë ai organ”,

Lutemi të na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin Tuaj,

K O M I S I O N E R I

Ermir KAPEDANI

